

Çfarë mund të bëni për të luftuar COVID-19

TESTIM




Mësoni gjendjen tuaj. Merrni teste falas të COVID-19 dhe të antitropave.

GJURMIM



Përgjigjuni thirrjes së gjurmuesve tanë të kontakteve për të ndihmuar ndalimin e përhapjes së COVID-19 në komunitetin tuaj.

PËRKUJDESJE



Veçohuni në mënyrë të sigurt për të mbrojtur të tjetër dhe merrni përkujdesje në hotel apo në shtëpi.

NYC Test & Trace Corps është i përkushtuar në mbrojtjen e privatësisë dhe të sigurisë së informacionit tuaj personal dhe shëndetësor. I gjithë informacioni është konfidencial dhe i mbrojtur sipas Kodit Shëndetësor të Qytetit të Nju-Jorkut. Test & Trace Corps nuk do të pyesë për statusin e imigrimit të askujt.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

 **Test & Trace
Corps**

Përkujdesuni të mbroni veten dhe të mbroni njerëzit tuaj të dashur nga COVID-19

Veçohuni në mënyrë të sigurt në një dhomë falas hoteli privat.


Nëse jeni diagnostikuar me COVID-19 apo nëse keni qenë në kontakt me dikë që ka rezultuar pozitiv, mund të kualifikoni për një dhomë hoteli për deri në 14 ditë për t'u veçuar në mënyrë të sigurt dhe për të mbrojtur njerëzit tuaj të dashur.

Hotelet e përkujdesjes janë të sigurt, komodë dhe praktikë. Të gjitha shërbimet janë falas. Fëmijët janë të mirëpritur.

Nëse zgjidhni të veçoheni në një hotel përkujdesjeje, kjo nuk do të ndikojë në përfitimet e tjera që merrni. Hotelet e përkujdesjes nuk ndikojnë në mundësinë tuaj për të aplikuar për qëndrim të përhershëm (kartë të gjelbër). Për më tej, trajtimi mjekësor apo shërbimet e kujdesit shëndetësor parandalues në lidhje me COVID-19 NUK do të preken nga rregulli i barrës publike.

Shërbimet e mëposhtme ofrohen FALAS në hotelet e përkujdesjes:

- Transporti vajtje-ardhje në hotel dhe vizitat e mundshme e të nevojshme mjekësore
- Dhomat private dhe banjat
- Testimi në vend për COVID-19
- Wi-Fi dhe televizion kabllor falas
- Telefonata pa kufizim për të ruajtur kontaktin me njerëzit
- Mëngjes, drekë dhe darkë çdo ditë*
- Shërbime përkthimi me gojë
- Dërgesa mjekësore
- Mbështetje me shërbimet e kujdesit shëndetësor në vend që ofrohen nga mjekë e infermiere të afta
- Telepsikiatri për të shfrytëzuar ofruesit ekspertë të shëndetit mendor



Prenotojeni dhomën tuaj sot.

Telefononi në nr. **1-844-NYC-4NYC**
(1-844-692-4692)
ose vizitoni **testandtrace.nyc**

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

Test & Trace
Corps

* Vaktet do të përshtaten sipas nevojave dietike